

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, dhe 193/24) dhe në lidhje me nenin 46 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4780/1 datë 19.11.2024 dhe Konkluzionin nr.02-5193/7 datë 26.12.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 46-të mbajtur më 25.12.2024 miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, për shkeljen e kryer të nenit 64 paragrafi (1) të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që në shërbimin programor televiziv të transmetuesit, më 4 nëntor 2024, emisioni i huaj sportiv për boks "*Masters of the spear* (Mjeshtrat e shtizës)" është transmetuar burimisht në anglisht, pa ofruar përkthim në gjuhën shqipe, në të cilin media transmeton program në përputhje me Lejen PA1 nr.08-61, datë 07.09.2023.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-4780/1 datë 19.11.2024, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyruar, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe datë e miratimit të tij llogaritet dita e certifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

A r s y e t i m

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia), në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, si dhe të paketat programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjetit publik të komunikimeve elektronike nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji në fjalë, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet e tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë - vërejtje publike në rastet kur bëhet fjalë për cënim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe aktet nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara në lejen dhe aktet tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 64, paragrafi (1) të LSHMAAV, transmetuesit janë të obliguar që programin ta transmetojnë në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik, dhe në rastet kur programi është i dedikuar për bashkësinë joshumicë, në gjuhën dhe shkrimin e asaj bashkësie.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për Çështje Programore, më 19 nëntor 2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, transmetuar më 4 nëntor, 2024. , në nivel lokal, ku konstatoi shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja është konstatuar se në shërbimin programor të SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, më 4 nëntor 2024, është transmetuar emisioni sportiv për boks "Masters of

the spear (Mjeshtrat e shtizës”, burimisht në anglisht, pa ofruar përkthim në gjuhën shqipe, në të cilën media transmeton program në përputhje me Lejen PA1 nr.08-61, datë 07.09.2023.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-4780/1 datë 19.11.2024, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar me datë 21.11.2024, dërgoi Shkresë ark.nr.10-4780/2 datë 21.11.2024, ku i dorëzoi dhe raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-4780/1 datë 19.11.2024, me pëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoi deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt më 25.11.2024, për të cilën në afatin e paraparë SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar nuk është deklaruar për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë, në seancën e 46-të mbajtur më 25.12.2024, shqyrtoi Raportin me shkrim dhe konstatoi që SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, në lidhje me nenin 64 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe pika 14 e Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për marrjen e masave (Tekst i pastruar) dhe Konkluzionin nr.02-5193/7 datë 26.12.2024, për shkak të konstatimit të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuara në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 25.12.2024, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar dhe urdhëron që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyruar, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-4780/1 datë 19.11.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.